

KLSH merr pjesë në trajnimin rajonal mbi “Krijimin e mbikëqyrjes gjithëpërfshirëse të sektorit të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut; dinamika brenda vendeve dhe sfidat rajonale”

Trajnimi i zhvilluar në Prizren, në datat 15-17 qershor 2022, u organizua nga Qendra Evropiane për Studime të Sigurisë, (CESS) Hollandë; Instituti për Studime Politike (ISP), Shqipëri; Instituti Kosovar për Hulumtime të Politikave dhe Zhvillim (KIPRED), Kosovë si dhe Instituti për Demokraci “Societas Civils” Shkup (IDSCS), Maqedonia e Veriut.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë aktivitet u përfaqësua nga znj. Boriana Nikolla me detyrë Drejtor i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit dhe Etikës, si dhe z. Koço Sokoli me detyrë Kryeauditues në Departamentin Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit dhe Etikës.



Tema e këtij kursi trajnimi ishte “Krijimi i mbikëqyrjes gjithëpërfshirëse të sektorit të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut; dinamika brenda vendeve dhe sfidat rajonale”. Gjatë këtij trajnimi u punua në mënyrë interaktive dhe u mbuluan tematikat me përmbajtje si qeverisja demokratike, e sektorit të sigurisë, kërcënimet e sigurisë nga dezinformimi dhe potenciali për mbikëqyrje gjithëpërfshirëse, siguria kibernetike-trendet dhe përgjegjësitë.

Përveç temës së trajtuar, trajnimi arriti të rrisë shkathtësinë e komunikimit në krijimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse drejt mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë duke favorizuar një bashkëpunim më të fortë dhe efektiv ndërmjet aktorëve të ndryshëm të mbikëqyrjes.

Një element me rëndësi të veçantë i këtij trajnimi, ishte dinamika rajonale, ku tre vendet pjesë e projektit DECOS, mësuan shumë nga njëri - tjetri, për sa i përket praktikave më të mira e më problematike të referuara në trajnim.